



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e shtatë e rregullt e Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë: **26.11.2020** (e enjte) duke filluar në ora **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-se;
2. Ridestinimi i mjeteve të ndara për Vizit-Pune jasht vendit, për qëllime tjera;
3. Raport nga D.SH.P, për ndërtimin e rrugës alternative për nevoja të Gurëthyesve, dhe njëherit raportim nga Policia për Sigurin në Trafik;
4. Raport nga Kryesuesi i shtabit Emergjent, për parandalimin e Pandemis Covid-19, në teritorin e Komunës Novobërdës;
5. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 17.11.2020
Në: Novobërdë



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e gjashtë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 26.10.2020, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, anëtarët e Kuvendit: Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Selatin Nuhui, Dobrivoje Djordjevic, Zymer Zymeri, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Xhejlane Behluli, Ivica Cenic, Predrag Stojkovic, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, zyrtar komunal dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendeti të pranishmit tha: para se të fillojmë me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë 13 antarë të Kuvendit nga 15 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojmë mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi i planit Aksional Komunal për të zhvendosur dhe kthim të qendrueshëm;
3. Aprovimi i propozim vendimit për shfrytëzimin e mjeteve të ndara nga MAPL;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti antarët e Kuvendit se a pajtoheni me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Dobrivoje Djordjevic pasi përshendeti të pranishmit tha: nuk pajtohem me këtë rend dite duke pas parasysh se në këtë kohë të pandemis ne po mirremi me shumë qështje të parendesishme dhe mendoj se edhe kolegu Jahiu pat të drejtë që e lëshoj mbledhjen, mendoj se për rend të ditës është duhur të shikohen edhe disa qështje të tjera të Komunës së Novobërdës. Edhe në mbledhjen e kaluar kam kërkuar që shtabi emergjent të dal me disa informata rreth gjendjes së pandemis në Komunë. Ne mbledhjen e kaluar kemi aprovuar bartjen e një shume të mjeteve, tash po më intereson dhe kerkoj nga Drejtori i Financave si dhe sherbimi i financave të na informoj se si do të ndahen ato mjete, ku do të ndahen dhe sa do të jetë shuma?, e posaqerisht po më intereson shkollat e komunitetit serb si do të jetë mënyra e procesimit e tenderimit dhe sa do të jetë shuma e mjeteve të ndara për shkolla pasi që une kam kuptu që ato investime shkojnë përmes investimeve kapitale. Pasi që ne e kemi aprovuar atë vendim kerkoj një informat se si do të shperndahen ato mjete?. Në mbledhjen e komitetit për komunitete zyrtari i arsimit na informoj se ende nuk kanë filluar të shpenzohen ato mjete, prandaj më intereson ta di se si do të ndahen ato mjete për cilat shkolla. Kishte qenë mirë që Drejtori të mbetet deri në fund të mbledhjes dhe në piken të ndryshme të na raportoj ose nese sot nuk ka informata për mbledhjen e ardhshme të na dergoj një raport me shkrim për të gjitha këto qështje që i ngrita.

Kryesuesi tha: pasi që permendet shumë qështje dhe nuk pat ndonjë pikë që mund ta cekim për rend dite por Drejtori mundë të komentoj rreth kësaj që ju diskutuat. Për qështjen e parë që e permendet

rreth pandemisë ndoshta në komitetin për komunitete keni mundur ta futni si pikë për rend dite, andaj mendoj se në mbledhjen e ardhshme të komitetit për komunitete ta kerkoni e pastaj ta propozoni për Kuvend edhe këtë qështjen tjetër që e permendet këto mjete që i kemi nda nuk besoj se Drejtori do të jetë në gjendje të raportoj për secilen pikë veç e veç por nese Drejtori ka ato informata mund ti ofroj.

Sercan Todorovic pasi pershendeti të pranishmit tha: shuma e mjeteve në total ka qenë mbi 273,000€ dhe atë ditë kur keni votuar e keni pasur listen para vetes se ku do të shkojn këto mjete, p.sh mbi 20,000€ për mallra dhe sherbime, mbi 120,000€ për investime kapitale, pra e keni pas listen dhe në bazw të asaj liste që e keni votuar do të shpenzohen.

Dobriwoje Djordjevic tha: unë atë propozim as që e kam pasur para vetes, por ka qenë një pjesë e mjeteve për investime kapitale, një pjesë në arsim, një pjesë në subvencione për bujqësi por ato mjete për investime kapitale si do të shperndahen pa procedur tenderimi, kjo është e paqartë. Po më interesojn vetem investimet në shkolla se si do të ndahen ato mjete.

Pasi nuk pati propozime konkrete për rend dite Kryesusi e hudhi në aprovim rendin e ditës.

Me 11 vota për, 1 kunder (Dobriwoje Djordjevic) 1 nuk ka votuar aprovohet rendi i ditës nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: kam shkrujt edhe email në momentin që e kam pranuar procesverbalin, në mbledhjen e kaluar kam votuar kunder propozimit të zv.Kryesuesit për kalimin e mjeteve prej njërit kod të subvencioneve në tjetrin, e dini të gjithë andaj për procesverbal kerkoj që ta permirsoni. Të njejtën kohë kam vëretje për mbledhjen e kaluar pasi që veç po ceket buxheti, unë si antare e LDK-së i kam pas dy propozime: njëri propozim nga partia dhe njëri nga unë si asambleiste perfaqësuese e votuesve të mi, nuk e keni hudh në votim asnjërin prej propozimeve të mija. Shumë jeni ngut atë ditë sa nuk e di pse u ngutshi dhe dul ne votim pa u marr parasysh asnjë propozim i im atë ditë. Unë i di se po punon në mënyrë subjektive dhe po ndikohesh edhe prej zv.Kryesuesit sa i perket votimit mirëpo duhet me dit punën të cilen e ka zv.Kryesuesi në momentin që më është shkel e drejta është duhur të reagoj. Tash një vit ndoshta sdo të jemi këtu por vetem një këshill puno ashtu siç është ligji merr vendime vet, zv.Kryesusi është i barabart me ne sa i perket votes jemi të gjithë njejt vetem duhet mbroj interesat e komunitetit shqiptarë, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: fillimisht tju njofotj se atë ditë dhe as herave të tjera nuk ka pasur propozime për listë të projekteve për shembull mu deklarë dikush se po propozoj në emer të LDK-së, PDK-së ose Serpska pasi që si të perfundojn zgjedhjet dhe ta dhëjna betimin si antarë të Kuvendit jemi perfaqësues të qytetarëve jo të partive. Sa i perket kësaj që e permendet se zv.Kryesusi nuk po e mbron interesin e komunitetit shqiptarë mendoj se jeni gabim, keni mundësin ta shikoni listen dhe aty të shikoni se mjetet e ndara janë në proporcion me qytetarët e Komunës. E di se kemi vështersi që çdo qytetari tja plotësojm deshirën duke pas parasysh buxhetin e limituar që e kemi.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i perket pikës se procesverbalit edhe unë kam vërejtje te faqja 4, ku Xhejlanja kundërshtoj me vend që ka votuar kunder, mirëpo këtu thuhet se me 8 vota për, 5 kunder votohet buxheti kjo nuk qendron ashtu pasi që aty është votuar për ndryshim të kodeve buxhetore dhe mendoj se është duhur të shkruhet që votohet buxheti për ndryshime të kodeve buxhetore. Sa i perket asaj që Xhejlanja tha se mu nuk më është dhënë e drejta mendoj kështu kur është propozuar lista e propozim projekteve personalisht ka votuar për atë listë dhe kur voton ti për atë list ska nevoj të votohet fare tjetra. Edhe një gabim teknik është në faqen e fundit në procesverbal të formimi i komisionit kur propozohet është Milica Jovanovic, ndërsa të vendimi është Mirjana Djordjevic kerkoj që të permirësohet.

Xhejlane Behluli tha: nuk po e di sa jam e qartë pasi që nuk kam pas mundësi me votu kunder projekteve që janë për fshatin tem, para se të hudhet në votim unë e kam një ankes që nuk u hudh propozimi im, para se të ndodh votimi ju thash se a keni mundësi mem perkrah për thurjen e varrezave në fshatin

Procesverbali i Kuvendit

Pasjak lagjja e re, pas fjales tem meniher jan hudh në votim projektet e juaja. Kryesues vetem ta perkujtoj se jam antare e partis së LDK-së.

Kryesuesi e hudhi në aprovim procesverbalin me vërejtjet e lartëcekura.

Me 9 vota për, 1 apstenim, 2 nuk kan votuar aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e dytë: Aprovimi i planit Aksional Komunal për të zhvendosur dhe kthim të qendrueshëm;

Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalën ZKKK Marko Markovic.

Marko Markovic pasi pershendeti të pranishmit tha: fillimisht tju njoftoj se shefja e zyres sot nuk ka pasur mundësi që të vij dhe me ka derguar mu. Nuk kam ndonjë prezantim të veçant pasi që kjo pikë ka qenë edhe më heret dhe e keni marr planin aksional me material por nese keni ndonjë pyetje do tju pergjigjem, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobriwoje Djordjevic tha: edhe në komitetin për komunitete është diskutuar kjo pikë dhe aty jemi pajtuar që të vij në Kuvend, vetem tju njoftoj se në pyetjen a e keni lexuar unë tash para mbledhjes e mora materialin, por mendoj se duhet të aprovohet ky plan.

Pasi nuk pati diskutime me 12 vota për aprovohet kjo pikë nga antarët prezent të Kuvendit dhe bihet ky:

VENDIM

Aprovohet vendimi për planin aksional Komunal për të zhvendosur dhe kthim të qëndrueshëm.

Pika e dytë: Aprovimi i propozim vendimit për shfrytëzimin e mjeteve të ndara nga MAPL;

Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic tha: MAPL-ja na ka nda disa mjete si Komunë për ti shpenzuar për menaxhimin e situates së pandemis, andaj ne si Komunë na duhet një vendim i Kuvendit që të na lejoj ti shpenzojm ato pare që na u kanë nda. Ato mjete janë 273,901.46€, qeveria gjegjësisht MAPL-ja ju ka nda të gjitha Komunave mjete për të menaxhuar më leht situaten e Covidit dhe këto mjete janë alokuar me kode buxhetore si zyrra e Kryetarit, kodi i buxhetor i bujqësisë dhe shendetësisë. Pra siç thash në fillim na duhet një vendim i Kuvendit që këto mjete të fillojm ti shpenzojm.

Ramush Mehmeti tha: ne në Kuvend po na vin disa pika në momentin e fundit të paqartësuar, e qartë është se kush i ka nda këto mjete por kjo shuma prej 193,901.40€ në kodin e Kryetarit për subvencione dhe transfere, nuk e dim se ku do të shpenzohen këto mjete. Kur reagoj më heret kolega Dobriwoje i tha shumë mirë i tha Drejtori se e keni pas agjenden ku i keni derguar ato mjete. Këto mjete jem dakort që ti kalojm por si do të shfrytëzohen?, ta dim se a do të ndihmohen qytetarët, a po ndihmohen punëtorët?, a po ndihmohen biznesi apo kush po ndihmohet?. Këto 70,000€ është e qartë që po ndihmohet biznesi në bujqësi, 10,000€ në arsim mallra dhe sherbime por këto 193,000€ nuk po e dim se ku po shpenzohen. Personalisht kerkoj prej të gjithë antarëve të Kuvendit që mos të marrim vetem vendime pa e ditur se ku do të shpenzohen këto mjete, ju faleminderit.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: fatkeqësisht Drejtori po vjen në Kuvend vetem ai kur ka kerkesa, ndersa nuk është i ndergjegjshëm ai me raportu për Raportin vjetor financiar dhe raportet tremujore financiare. Po kthem te kjo pike 193,000€ të arsyetohen vetem me dy faqe është absurde. Këtu po shkrun se me konsultim ne të gjithë Drejtorët e Komunës kemi vendosur që të ndryshojm kerkesen e mëhershme me këtë kërkesen e tashme për shperndarjen e mjeteve lidhur me menaxhimin e situates se krijuar me pandemia. Është duhur që të kemi një tabel, një planë në mënyrë që të dim se cila Drejtori sa mjete i merr?. I bëjë thirrje Drejtorit dhe gjithë Komunës që të jenë më të pergjegjshëm më Kuvendin Komunal.

Sercan Todorovic tha: sa i perket shpenzimit të këtyre mjeteve, fillimisht duhet ta bim vendimin që këto mjete që i ka nda Ministria kemi të drejt ti shpenzojmë, kur të bihet vendimi më pas formohet komisioni që ndan shfrytëzimin e këtyre mjeteve në bazë të nevojave.

Ramush Mehmeti tha: më vjen keq Drejtor po çdo herë po thuani kështu por në realitet ashtu spo veproni. Që 3 vite është nda materiali ndertimor asnjëherë nuk është raportuar se kush ka marrë. Kush do që ka perfituar prej Komunës nuk jam kunder, mirëpo pse të mos jetë publike. Janë nda makina bujqësore, kurr lista su bë publike dhe këto 190,000€ me u votu sot po ju garantoj se kurr skan met vet për asgjë por do të ndahen ashtu si dojn vet.

Kryesuesi tha: pajtohem me zt.Mehmeti se ndarja e këtyre mjeteve nuk do të jetë transparente dhe nuk do të kemi informata se kush do të perfitoj, shpresoj se nuk është sot dita e fundit, edhe pse ktu shkrun se këtu është 21 shtatori dita e fundit. Kemi mundur pra edhe në mbledhjen e kaluar ta marmi këtë vendim. Sercan Todorovic tha: me 21 shtator e kemi derguar shkresen në Ministri e më pas është kthyer pergjigjja prej Ministrisë.

Kryesusi tha: është për tu habitur se sa herë po vini në Kuvend po vini me afate të kufizuara, nese e aprovojme këtë vendim që të shfrytëzohen këto mjete prap si Kuvend do të vim në një situat se jemi fajtorë pasi që kemi dhënë leje që të shfrytëzohen. E sa i perket transparences kjo mos transparenc ka filluar qysh prej shprendrjes së lopëve që e kemi marrë vendimin në Kuvend për ta formuar komisionin dhe qysh prej atëherit ka filluar Komuna që mos të jetë transparente.

Dobrivoje Djordjevic tha: heren e kaluar kur unë kam qenë kunder që të barten ato mjete ju keni qenë për, sot po shihet që ju jeni kunder unë do të jem për, nese do të keqperdoren këto mjete do të keqperdoren edhe ato më herët.

Zymer Zymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: unë do ta votoj këto mjete se ata që nuk votojn janë kunder popoullit të Novobërdës. Qeveria na ka lëshuar mjetet ato dikund do të shfrytëzohen e pse ne mos të biem vendim që të shfrytëhohen. Unë nuk e di si mundet dikush ti kthej mjetet e Komunës së vet mbrapa por perseri secili e ka mendimin e vet.

Ramush Mehmeti tha: vetem një sqarim ne nuk jemi duke i refuzuar këto mjete por kerkojm arsyetim se ku do të shkojnë, ne duhet të diem si antarë të Kuvendit se ku po i qojmë këto mjete pasi që këto mjete nuk humbin këto janë në llogari por vetem duhet të shpenzohen andaj nese ka plane konkrete mundemi të thirrmi seanc të jashtzakonshme dhe do të votojm por kështu në këtë form pa u ditur se ku do të shpenzohen 190,000€ si të vojm.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: unë edhe heren e kaluar kur është votu buxheti kam qenë kunder heqjes së subvencioneve edhe në bujqësi edhe të materialit ndertimor, e njehta situat kur kemi bërë bartjen e mjeteve te të hyrave vetanake, perseri është votu e njehta. Tash jemi në një situat që paska një shumë të madhe të subvencioneve në zyre të Kryetarit, por besoj se ka edhe mënyra tjera se si mundemi mi gjet edhe keqperdorimet, nese ka shkelje qoftë në subvencione në bujqësi ka mënyra si ti ndjekim penalishtë. Unë jamë për ndarje të këtyre subvencioneve por do ta percjelli me vemendje mënyren e ndarjes.

Selatin Nuhiu tha: është një shumë e konsiderueshme mjetesh por ne jemi këtu për qytetarët, andaj propozoj të mbajm një pauz prej 5min që të konsultohemi, ndoshta Drejtori ka material shtesë.

Sercan Todorovic tha: unë nuk mundë të ju them në detale se ku do të shpenzohen këto mjete, e dini se këto mjete janë të Ministrisë dhe Ministria do ta bëjë mbykqyrjen se ku do ti shpenzoj. Ministria ka kerkuar nga ne që të formojm një komision prej 5 antarëve dhe këto mjete do të shpenzohen vetem permes fteses publike, ata që kanë pasur dëme nga pandemi kanë të drejt të aplikojn që të rimbursohen.

Ramush Mehmeti tha: tash është arsyetmi i qartë, unë gjatë gjithë kohes kerkova arsye se si do të shpenzohen, pasi që është me ftesë publike dhe ka arsyetim jam që të kaloj kjo pikë.

Pasi nuk pati tjera diskutime me 12 vota për votohet kjo pikë nga të gjithë antarët prezent të Kuvendit dhe bihet ky:

VENDIM

Për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve të ndara nga MAPL-ja, në lartësi prej 273,901,46€, nga ana e Komunës së Novobërdës, simbas propozimit të pranuar nga Ministra së lartëpërmendur.

Procesverbali i Kuvendit

Sercan Todorovic tha: duke pas parasysh se u aprovu vendimi që këto mjete të kemi të drejt ti shpenzojmë, në bazë të kërkesës së Ministrisë Kryetari e ka propozuar komisionin prej 5 antarëve që do ta mbikqyre shperndarjen e këtyre mjeteve. Ky komision do ta mbikqyr implementimin e këtij projekti.

Kryesuesi tha: siç e prezantoi Drejtori i Financave e kemi propozimin nga Kryetari për formimin e komisionit për mbikqyrje të implementimit të këtij projekti pra ky komision në bashkpunim me MAPL-ën do ti mbikqyr këto projekte. Ky komision është propozuar në këtë përbërje: Cvetkovic Zoran, Vlastimir Aleksic, Bajram Abazi, Selatin Beqiri, Milos Denic.

Selatin Nuhiu tha: Drejtori nuk po tregohet i sinqert në raport me Kuvendin pasi që nuk i tregoj këta emra para se mu hudh në votim dhe kjo nuk është e sinqert.

Sercan Todorovic tha: skam mujt me e propozu komisionin pa pasur vendim me i shfrytëzu mjetet.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 12 vota për votohet kjo pikë nga antarët prezent të Kuvendit dhe bihet ky:

VENDIM

FORMIMIN E KOMISIONIT MBYKQYRËS :Cvetkovic Zoran – Kryetar i Komisionit
Vlastimir Aleksic – Antarë
Bajram Abazi – Antarë
Selatin Beqiri – Antarë
Milos Denic – Antarë

Pika e katërt: Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Sercan Todorovic tha: antarët e KPF-së janë njoftuar me gjendjen që e kemi prej mbledhjes së kaluar, kur Kuvendi e ka aprovuar propozim buxhetin, të njejtin propozim të aprovuar e kemi derguar në Ministri të Financave, fatkeqësishtë ai buxhet është kthyer që edhe njëher të rishqyrtohet dhe të aprovohet në Kuvend. Pasi që nuk e kanë të gjithë antarët e Kuvendit këtë vendim po ju citoj se këtu po shkruan se Komuna e Novobërdës e ka ndryshuar strukturen e shpenzimeve duke e zvogluar shumë e mjeteve në kategorin e subvencioneve prej 33,586€ dhe mallrave dhe sherbimeve në vlerë prej 150€ por këtu ka qenë gabim teknik dhe këto mjete të marra nga subvencionet janë bartur në shpenzime komunale. Andaj në bazë të nenit 61.3 të Ligjit për Buxhet kerkojm që këto mjete të rikthehen prapa, nese nuk e bëjmë këtë ndryshim atëher shumë lehtë nga muaji mars i vitit 2021 mundë të mbesim pa buxhet, këtë informat që ju barta ju është informat që e kam marrë nga Ministria e Financave.

Dobrivoje Djordjevic tha: e kisha një propozim nga mbledhja e ardhshme e Kuvendit deri sa të zgjat situata me pandemi ta kemi një pikë të posaqme për shqyrtimin e situates rreth pandemisë të na raportoj dikush në mbledhje të Kuvendit. Këtë raport të na jep ose Drejtori i shendetësisë ose ndonjë antarë i atij shtabi emergjent.

Ramush Mehmeti tha: unë po e marr fjalën për kërkesen e Drejtorit të Financave, po i them Drejtorit bënu më i sinqert dhe sqaroj më mirë pikat. Sa i perket buxhetit të kthyer pra një gabim është teknik ashtu siç e ceket dhe gabimi tjetër është transferi i kodeve. Unë jam dakord që ta permirësojm atë bartje pasi që është edhe vendimi prej Ministrisë.

Xhejlane Behluli tha: në momentin që është propozuar kam qenë gjithëmon kunder që jeni duke vepruar kunder ligjit, e sqaroj edhe zyrtari në mbledhje, dmth kemi pasu mundësi që të mos vim deri këtu.

Kryesusi tha: propozoj njëher që të anulohet vendimi i mbledhjes së kaluar për bartje të këtyre mjeteve.

Me 11 vota për, 1 nuk ka votuar aprovohet nga antarët prezent të Kuvendit ky propozim dhe mirret ky:

VENDIM

Për anulimin e aprovimit të buxhetit për periudhën 2021/23 të datës 29.09.2020 me nr. Protokolit 01-612.

Më pastaj Kryesusi e hudhi në votim propozimin e Drejtorit të Financave që mjetet e subvencioneve të kthehen prej shpenzimeve Komunale në vlerë prej 33,586€.

Me 11 vota për, 1 nuk ka votuar aprovohet nga antarët prezent të Kuvendit ky propozim dhe mirret ky:

VENDIM

Për aprovimin e buxhetit për periudhën 2021/23, që mjetet nga shpenzimet komunale të barten në kategorin e subvencioneve në vlerë prej 33,586€.

Xhejlane Behluli tha: pajtohem plotësisht me vërejtjet e asamblesistit Jahi Zeqiri, ju lus që atë ditë që është mbledhja të vini më heret e të shikoni se a ka kushte teknike për mbledhje.

Dobriwoje Djordjevic tha: kerkoj qe të votohet që shtabi emergjent të vij të raportoj.

Ramush Mehmeti tha: ka të drejt kolegu që të kerkoj nga shtabi emergjent të raportoj rreth kësaj situate.


Zymer Zymeri tha: une e pyes këtë kolegun se ku është duke jetuar pasi që në Komunën tonë nuk ka raste.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:20.

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic

Kryesues i Kuvendit

